



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 23.1.2012, ora 9,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH, zyrtar nga Ambasada Amerikane me ekspertin Martin Perler, Deputeti Hydajet Hyseni, Gjejlane Hoxha, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës ,**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 17.1.2012,**
- 3. Takimi me ekspertin Amerikan,**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.1.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.1.2012.

3. Takimi me ekspertin Amerikan

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe mysafirët nga Ambasada Amerikane të cilët kanë shprehë gatishmërinë për kontributin sa i përket njohurive rreth trashëgimisë kulturore. Ai ftoi ekspertin **Martin Perler** që përmes monitorit të sqaroi dukurinë e trashëgimisë kulturore atje në Amerikë, që do të konsiderohet mjaft e dobishme për këtë komision, sidomos tani kur ky komisioni është duke shqyrtuar projektligjet për Hoçën dhe Prizrenin si qendra të rëndësishme kulturore në Kosovë. Eksperti Amerikan z. Perler falënderoi për këtë mundësi dhe sqaroi fillimisht se në Amerikë trashëgimia kulturore emërtohet ndryshe : **PREZERVIMI HISTORIK**. Në këtë informatë që kishte përgatitur për komisionin, ai kryesisht u fokusua çka përfshin ky prezervim në Amerikë. Në këtë lëmi përfshihen shumë akter, OJQ, shteti dhe njerëz me aftësi dhe profesione të ndryshme (arkitekt, historian, specialist të ndryshëm) të cilët bashkërisht japin kontributin e tyre për vendet, ndërtesat (sidomos ato të vjetra), gjallesat etj të cilat janë me rëndësi të veçantë për Amerikën, të cilat vende pastaj ripunohen, rregullohen etj në mënyrë që në fund rezultati është : kënaqësia e veçantë për vendorët dhe turistët por edhe gjenerimi i mjeteve financiare (Amerika shumë më tepër përfiton nga vendet kulturore historike sesa nga turizmi i thjesht nëpër plazhe). Këto vende kanë rëndësinë e veçantë jo vetëm sa i përket ruajtjes së tyre por edhe planifikimit që duhet bërë për të gjitha komunitetet që jetojnë në SHBA. Në Amerikë ekzistojnë 86.000 vende historike, 10.000 distrikte historike dhe shumë qyteza e fshatra të rëndësishme (për nga ngjarjet historike etj). Ai në vazhdim mori shembull disa qytete të cilat tregojnë veçantinë e një prezervimi historik për ndonjë ngjarje historike etj : Santa Fe-tradita e ndërtesave sipas stilit të veçantë arkitektonik, Masachusec-e njohur me komunitete të veçanta, Tombstone-Arizona-stili i perëndimit të egër (“kaubojët”), Charlestone-stili i shtëpive karakteristike, Florida-arte të veçanta, New Cersey-aritjet e veçanta historike të anijeve me avull, me vela etj, New Mexico-“qyteti i qiellit” (më se 800 vjet) dhe ndërtesat me kashtë, prej lloqi, jeta pa rrym, pa ujë (mënyra e jetesës të cilën kanë zgjedhë disa banorë sipas kulturës shumë të vjetër), zona e LUIZIANËS me njerëz të prejardhjeve të ndryshme, momente historike p.sh. sulmi Japonez në Pearl Harbour, qytete Kineze në Honollullu, shtëpia historike e George Washingtonit (kryetari i parë Amerikan) prej kohës kur ka qenë gjeneral, të cilin shtëpi e ka rinovuar një shoqatë e grave e cila ende funksionon sot në Amerikë. Më 1966 prezervimi historik u bë politikë zyrtare e shtetit me ç’rast është nxjerr edhe Ligji për këtë qëllim, ku merr pjesë aktive edhe Qeveria, prej kësaj kohe edhe shteti rregullisht participon në këtë fushë sipas shumave të caktuara për vendet që vlejnë të prezervohen, ngase Ligji lejon këtë. Shumë ndërtesa të vjetra ose të braktisura në Amerikë tanimë janë shndërruar në zyra funksionale ose në vende atraktive, gjitha këto bëhen me një qëllim ngase Amerika ka një histori të ndryshme e cila begatohet gjithnjë e më tepër. Zhvillimi ekonomik është gjithashtu një arsye shtesë pse bëhen këto prezervime : krijohen vende të reja të punës për shumë profesione të ndryshme, biznese etj. Shumica e Amerikanëve (78%) janë të interesuar më tepër për vende kulturore. Gjatë një viti Amerika ka përfituar 192 miliard dollar nga ky lloj i turizmit kulturor. Këto prezervime bëhen edhe me qëllime tjera si p.sh. planifikimet automobilistike, rrugët që krijojnë probleme, funksionimi i një vendi pa automjete, lëvizjet me biçikleta etj.

Nait Hasani falënderoi në emër të komisionit për njoftime shumë të mirëseardhura dhe përvojat e SHBA-ve në këtë fushë. Ai tha se kjo informatë poçes ndërlihet me dy projektligje aktuale në këtë komision, do të shohim se mentaliteti Ballkanik është pak më ndryshe ku ka pasur mjaft edhe konflikte, ndaj kërkoi një qartësim në këtë drejtim. **Vjosa Vela** kërkoi sqarimin rreth dallimit të Ligjit të atjeshëm dhe këtushëm për trashëgiminë kulturore dhe a ka atje listë të monumenteve historike. Z. Perler tha se trashëgimia Amerikane është një amalgamim i trashëgimive të ndryshme të përziera, për atë arsye është edhe interesante, dhe gjithnjë bëhet edhe më atraktive për shkak të popullatës së larmishme, kjo është pasuri për shtetin. Ai pohoi se shteti e ka listën e vendeve për të cilin ishte pyetja. **Gjejlane Hoxha** falënderoi për njoftimin e ekspertit dhe konstatoi se dy projektligjet në procedurën e këtij komisioni (Hoça dhe Prizreni) janë fatkeqësisht imponim i politikës dhe me kritere të panjohura deri tani, derisa një ligj duhet të jetë stimulim (sikurse në SHBA). Ajo kërkoi ndihmë nga eksperti sa i përket mbrojtjes së

monumenteve historike në Kosovë. Një konstatim të ngjashëm kishin edhe **Hydajet Hyseni, Liburn Aliu** të cilët kërkuar që politika të ndahet nga trashëgimia kulturore, në mënyrë që të hapet rruga e vëllazërimit midis njerëzve (sikurse në SHBA). **Sevdiqe Lama** u pajtua sidomos me fokusimin e ekspertit sa i përket jo vetëm monumenteve të vjetra, por edhe ndërtimeve të sotme, sidomos ato pa leje që tregojnë se një qytet duhet të mbrohet në brendi. **Daut Haradinaj** gjithashtu falënderoi dhe konstatoi se këto dy projektligje të kritikuar burojnë nga pakjoja e Ahtisarit dhe parashihet të përmbyllin mbikëqyrjen ndërkombëtare të Kosovës, megjithatë shprehu mendimin se nuk do të krijojnë ndasi midis njerëzve ngase Kosova do të ngadhënjë ndaj tendencave për ndarje (fetare). **Nijazi Idrizi** konstatoi se për këto projektligje nuk janë shpenzuar debatet, sidomos nga Qeveria. Vlerat e përbashkëta janë ruajt nga komunitetet në këto dy zona, por nuk ka pas debat të mjaftueshëm dhe trajtim të përbashkët, ndaj në vazhdim është droja që mos të ndodhë kështu edhe me vende tjera, nevoja të mbrohet një vend me një ligj.

Lidhur me konstatimet dhe pyetjet e anëtarëve të komisionit, eksperti Amerikan u kundërpërgjigj se Amerika është shumë e gjerë dhe i thellë sa i përket kësaj fushe, ndaj krahasimi me Kosovën do të ishte e pamundur, mirëpo ai shprej se shembujt e cekur do të ndihmojnë Kosovën dhe Komisionin në këtë drejtim. Zyratari Amerikan sugjeroi një bisedë rreth vizitës së mundshme të Komisionit në Amerikë, kur mund të ndodhë etj, pasi që ata janë të interesuar të kontribuojnë.

Nait Hasani falënderoi për këto ndërhyrje nga anëtarët e komisionit dhe zyrtarët nga Ambasada Amerikane, konstatoi se kjo informatë nga eksperti Amerikan ishte një njoftim gjeneral, ndaj sugjeroi të përfundoi takimi me një falënderim për ekspertin Amerikan.

Në vazhdim (në restorantin RINGS) komisioni fillimisht vendosi për delegacionin e komisionit që do të vizitoj Sarajevën prej 22-25 shkurt 2012, sipas njoftimit nga Sekretaria dhe për të cilin do të hartohet kërkesa si është sugjeruar me atë njoftim, si vijon : **Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Salih Morina, Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.**

Kryetari i Komisionit Nait Hasani, ashtu si ka sugjeruar, njoftoi komisionin me draftin e përgatitur nga stafi për Planin e Komisionit për këtë vit, i cili plan u bazua në strategjinë e propozuar nga Qeveria dhe e cila duhet të miratohet në shkurt nga Kuvendi i Kosovës. Komisioni bëri ca ndryshime dhe obligoi stafin të plotësoi me këto sugjerime, ndërkaq planin do ta miratoi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani